



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

---

Numri i lëndës: 2020:069928

Datë: 11.01.2021

Numri i dokumentit: 01439102

**C.nr.985/20**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Mirlinda Bytyqi Rexhepi, në çështjen juridike kontestimore sipas padisë së paditësit Rr.S., të cilin e përfaqëson me autorizim av.Leutrim Ademi nga Mitrovica, kundër të paditurës Universiteti i Shkencave të Aplikuara “Ferizaj”, të cilën e përfaqëson me autorizim av.Armend Hysaj nga Ferizaj, për kompensimin e shujtës ushqimore, në seancën e mbajtur me datë 18.12.2020. ndërsa e përpiloi me datë 11 janar 2021 këtë :

**A K T G J Y K I M**

**I.APROVOHET** në tërësi kërkesëpadia e paditësit Rr.S., si e bazuar.

**II.OBLIGOHET** e paditura e paditura Universiteti i Shkencave të Aplikuara Ferizaj, që në emër të kompensimit për shujtën ushqimore të paraparë në kontratën kolektive të dt.18.04.2017, paditësit ti paguaj shumën për shujtë ushqimore për 638 ditë pune x2€ shumen prej 1,276€, me kamate ligjore prej 8% nga dita e ushtrimit të paditëse datë 16.06.2020 e deri në pagesën definitive.

**III.DETYROHET** e paditura që ti paguaj shpenzimet e shkaktuara kontestimore në shumë të përgjithshme prej 260 euro, pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi e nën kërcenim të përmbarimit të dhunshëm.

**A r s y e t i m**

Paditësi përmes të autorizuarve të tij ka paraqitur padi në gjykatë me datë 16.06.2020 dhe në seancën e dt. 18.12.2020 i autorizuari i tij av.Leutrim Ademi ka deklaruar se mbetet në tërësi

pranë padisë dhe kërkesëpadisë dhe precizimit të saj, ashtu që gjykatës i propozon që padinë dhe kërkesë padinë e paditëses të e aprovoj në tërësi si të bazuar dhe të detyrojë të paditurin që të njëjtës në emër të kompensimit të shujtës ushqimore të paraparë në dispozitat e kontratës kolektive si në padi të i paguaj me kamatë ligjore nga dita e ushtrimit të padisë e deri në pagesën definitive

Përfaqësuesi i të paditurës Armend Hysaj në seancën te dt.18.12.2020 ka deklaruar se mbetet edhe më tutje pranë përgjigjes ne padi për shkak se universiteti nuk ka pasur mjete buxhetore për të kompensuar shujtat sipas paditësit, dhe kërkon nga gjykata që kjo padi të refuzohet si e pa bazuar, precizimin e ka pranuar të njëjtën nuk e ka kundërshtuar pasi provat janë të bazuara në vërtetimin e të paditurës.

Gjykata me qëllim të vërtetimit të drejtë të gjendjes së fakteve ka bërë administrimin e provave si vijojnë: *kërkese drejtuar të paditurës nr.745/20 dt.28.02.2020, Vendim nr.766/20 dt.02.03.2020 , Kontratë pune në emër të paditësit, Precizim i kërkesëpadisë dt.18.12.2020, precizim i shpenzimeve dt.18.12.2020 , Vërtetim mbi ditët e prezencës ne Pune nr.3030 dt.20.11.2020.*

Gjykata, pas administrimit të provave, ka bërë shqyrtimin e tyre veç e veç si dhe të ndërlidhura si tërësi mes veti, mbi bazën e bindjes së saj të lirë në kuptim të nenit 8 të LPK-së, ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar dhe ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

Gjykata ka vërtetuar gjendjen faktike, se nuk ishte kontestuese në mesë palëve ndërgjygjësese se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura dhe nga data 18.04.2017 kur dhe ka hyrë në fuqi Kontrata Kolektive deri me datën 11.03.2020, ka qenë në vendin e punës për 638 ditë pune, respektivisht është vërtetuar prezenca e tij në vendin e punës në ditët e precizuara për paditësin, nuk ishte kontestuese edhe lartësia e kërkesëpadisë por kontestuese ishte baza juridike e kërkesëpadisë se a i takon paditësit shuma e kërkuar.

Gjykata përmes kontratave të punës të cilat janë administruara ka vërtetuar faktin se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura.

Gjykata me vërtetimin e dt.20.11.2020 për ditët në punë dhe përvojën e punët të paditësit lëshuar nga Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, ka vërtetuar faktin e ditëve të pranisë të paditësit në vendin e punës nga data 08.04.2017 kur ka hyrë në fuqi Kontrata Kolektive deri me datën 11.03.2020.

Gjykata me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë është bazuar në faktin se me Kontratën Kolektive të nënshkruar nga Qeveria e Kosovës-Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, për punëmarrësin Bashkimin i Sindikatave të Pavarura të Kosovës e cila është nënshkruar nga ana e dy palëve dhe në neni 49 të kësaj kontrate përcaktohet se kjo kontratë hynë në fuqi me ditën e nënshkrimit nga palët nënshkruese.

Në pjesën hyrëse respektivisht në nenin 1 të kontratës kolektive është e përcaktuar qartë se kush përfiton nga kontrata kolektive e që në rastin konkret paditësit e kanë shfrytëzuar një të drejtë pasi që të njëjtit përfitojnë nga kjo kontratë për faktin se për periudhën nga data 18.04.2017 deri me datën 11.03.2020, ka qenë në vendin e punës respektivisht prezenca e tij në vendin e punës i cili fakt është vërtetuar përmes vërtetimit mbi ditët e prezencës në punë është paraparë që të punësuarve u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë, për një ditë pune është 2 euro, për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore, andaj gjykata sa i përket aprovimit të lartësisë kërkesëpadisë në lidhje me ushqimin e ka bazuar duke e llogaritur ditët e pranisë në punë të paditësit e duke e shumëzuar me 2 euro për secilën ditë të pranisë së tij në vendin e punës.

Andaj duke u nisur nga dispozitat ligjore të lart cekura të Kontratës Kolektive, si dhe gjendjes faktike, rezulton që kërkesëpadia e paditësit është e bazuar ku dhe e ka detyruar të paditurën që paditësit të i paguaj shumat e specifikuar në pikën II të dispozitivit, në një të anë kurse në anën tjetër e paditura nuk e ka përmbushur obligimin siç e ka pasur për detyrim sipas Kontratës Kolektive e datës 18.04.2017, sa i përket mjeteve monetare për ushqim të specifikuar për secilin paditës veç e veç sikurse në pikën II të dispozitivit.

Duke u bazuar në ditët e prezencës në punë rezulton që paditësi Rr.S. ka qenë në punë për 638 dite e cila nuk ka qenë kontestues për të paditurën e që sipas kontratës kolektive të arsimit, shuma për shujtë ushqimore është 2 €, për 638 ditë pune x2 kap shumën prej 1,276€.

Sa i pretendimit të përfaqësuesit të paditurës se kërkesëpadia e paditësit duhet të refuzohet për faktin se e paditura nuk ka mjete financiare që ti përmbushë këto detyrime ndaj paditësve, këto pretendime për gjykatën janë të pa bazuara për faktin se me nenin 2 të kësaj kontrate të gjitha DKA e institucioneve të arsimit të lart, në rastin konkret e paditura është e obliguar që ta zbatojë këtë kontratë kolektive dhe me kohë të planifikojë buxhetin me kohë për këto raste, e jo

të thirret se nuk ka mjete të destinuara për këto raste, andaj edhe përgjegjësia në rastin konkret është tek e paditura e jo tek paditësit.

Sa i përket shpenzimeve të procedurës gjykata duke u bazuar në nenin 452 par 1 të LPK-së e ka obliguar të paditurën që paditësit t'ua paguaj shpenzimet e procedurës në shumë të përgjithshme prej 260€ atë për përpilim të padisë shumë prej 104 €, për taksën gjyqësore për padi 21€, dhe për përfaqësim të një seance 135€

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## **GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**

C.nr.985/20 datë 11 janar 2021

**Gjyqtarja**

Mirlinda Bytyqi Rexhepi

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes në dorëzim, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.